



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology
and Innovation*

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.7, nenit 8 si dhe Shtojcës 7 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 09.08.2023, Udhëzimin administrativ nr. 20/2023 të datës 04.08.2023 për krijimin e skemave për mbështetje financiare të studentëve për ndarjen e bursave dhe të vendimit nr. 3507 të datës 25.10.2023, nxjerrë;

K O N K U R S

Për e ndarjen e bursave për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duke synuar mbështetjen e shkollimit të studentëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë regjistruar në nivelin bachelor në një të një nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës shpall këtë thirrje për mbështetje financiare.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare është 1,000 € (një mijë euro) për student/e. Numri maksimal i bursave do të jetë 100.

Kushtet për aplikim dhe përparësitë në konkurrim:

1. Aplikantët duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të jetë pjesëtarë i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
3. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e regjistruar në nivelin bachelor që përmbushin kriteret si më poshtë;
4. (Për vitin e I) Të jetë i regjistruar për herë të parë në studimet bachelor në vitin akademik 2023/2024 në një të një nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës;
5. (Për vitet II, III, IV) Të ketë të regjistruar vitin akademik 2023/2024;
6. Përparësi kanë studentët me notë mesatare më të lartë;
7. Përparësi kanë studentët të cilët nuk kanë përsëritur vitin akademik;
8. Përparësi kanë personat me aftësi të kufizuara;

9. Për të rritur përfaqësimin e grave në mesin e studiuesve, gratë do të zgjidhen me preferencë në rastet e kualifikimit të barabartë të kandidatëve gra dhe burra;

10. Të drejtë aplikimi nuk kanë studentët të cilët kanë përfituar nga ndonjë mbështetje tjetër financiare gjatë vitit akademik 2023/2024.

11. Të drejtë aplikimi nuk kanë studentët të cilët kanë kaluar dyfishin e studimeve.

12. Të drejtë aplikimi nuk kanë studentët të cilët kanë përfunduar ligjeratat në vitin e fundit të studimeve.

Dokumentet e kërkuara:

1. Dëshminë e regjistrimit në fakultet/Vërtetimin e statusit të studentit;
2. Vërtetimin e statusit të studentit;
3. (Për studentët e vitit 2-4) Transkriptën e notave;
4. Formularin e vetëdeklarimit mbi përkatësinë etnike;
5. Kopjen e letërnjoftimit;
6. Konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive;
7. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për personat me aftësi të kufizuara sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim (pika 8).

Forma dhe procedurat e aplikimit e aplikimit:

1. Aplikimi bëhet përmes platformës eKosova
2. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
3. Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI-t

Konkursi do të jetë i hapur nga data: 26/10/2023 deri më 06/11/2023, në ora 16:00.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës dhe janë refuzuar, kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI-t, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASHTI.